

TAHAR BEN JELLOUN

**PAGJUMËSIA**

ROMAN

---

BOTIMET TOENA



TAHAR BEN JELLOUN

PAGJUMËSIA

*roman*

Përktheu nga origjinali frëngjisht  
Nonda Varfi

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Autori: Tahar Ben Jelloun (Tahar Ben Zhelun)

Titulli në origjinal: L'insomnie

Botoi në frëngjisht: Gallimard

Cet ouvrage a bénéficié du soutien du Programme d'aide à la publication du ministère français de l'Europe et des Affaires étrangères, ainsi que du soutien des Programmes d'aide à la publication de l'Institut français.

Ky libër është mbështetur nga Programi i Ndhmës për Botim i Ministrisë Franceze të Europës dhe të Punëve të Jashtme, si edhe nga Programet e Ndhmës për Botim të Institutit Francez.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare dhe përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-277-82-4

© Editions Gallimard, 2019

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

## Kapitulli 1

Vrava nënën. E mbyta me jastëk. I mëshova pak. Nuk bëri asnjë lëvizje. Ndaloj së marri frymë. Kjo është e gjitha. Pastaj, bëra një gjumë të thellë që zgjati.

Duhet të kem fjetur orë të tëra, sepse pashë shumë ëndrra mjaft të bukura, të ndritshme, plot ngjyra, kundërmuese.

Ishte hera e parë që kaloja një natë të tërë në gjumë të thellë, qetësues, ripërtëritës. Nuk u ngrita as për të urinuar. E çuditshme, sepse zakonisht çohem çdo dy orë. Kam fshikëz të vogël, që me kalimin e moshës është bërë jotolerante. Por, këtë herë, asgjë.

Në mëngjes u ndjeva mirë, i freskët dhe, si thonë, në formë. Nuk ndjeva as brengën më të vogël, as turp, as drojë. Kam shkruar shpesh histori me vrasje, të tjerra mirë - jam skenarist. Kjo gjithmonë më ka argëtuar dhe producentët më kanë kërkuar shumë të tilla. Këtë herë u zgjova vrasës. Nuk shpikja më histori, kisha nisur t'i jetoja dhe të përfitoja nga ato. Si me magji kisha kaluar nga shkrimi në jetë.

Në ditët që pasuan, për herë të parë, nisa ta prisja natën me padurim. Ajo ishte bërë mikeshë. Pagjumësia më kishte braktisur. Isha normal. Nuk kisha nevojë për ilaçe gjumi ose qetësues.

Askush nuk shfaqti dyshimin më të vogël. Njerëzit thoshin: “Ishte me fat! Vdiq në gjumë, vdekje e bukur”. Unë tundja kokën dhe përsërisja pas tyre “po, vdekje e bukur, nuk vuajti”.

Por, disa muaj më pas, netët e mia u bënë përsëri net ferri...

Në dhomë, perdet ishin të trasha dhe të mbyllura. Një perde midis botës dhe meje. Doja të isha vetëm. Të mos dëgjoja asnjë zhurmë. I kisha marrë të gjitha masat që asgjë të mos ma prishte gjumin. Xhama të trefishtë. Shtrat cilësor. Çarçafë të shkëlqyer prej pambuku. Jastëkë të zgjedhur me kujdes dhe të përshtatur në mënyrë të përkryer me pozicionin e kokës. Shishe me ujë te komodina. Transistor i vogël. *iPod* për të dëgjuar muzikë. Qilim për të bërë natën ushtrimet qetësuese për frymëmarrjen. Me pak fjalë, asgjë nuk e pengonte dot gjumin të më merrte në hullinë e tij. Por isha i privuar nga kjo dhuratë. Gjumi nuk vinte më.

## Kapitulli 2

Gjithçka rridhte sikur efektet anësore të krimeve, që kisha bërë, ishin zhdukur pak nga pak. A duhej të vrisja për të mposhtur pagjumësinë?

Natën kaloja në mendje njerëzit që më rrethonin dhe pyesja veten se cilin do të zgjidhja. Motra e madhe e nënës kishte probleme me shëndetin. E doja shumë, ishte hokatare, e zgjuar, por shumë raciste. Për të, zezakët nuk ishin njerëz, ishin skllëvër. Bota kështu ishte. Ajo e pranonte se kjo nuk ishte e drejtë, por ishte vullneti i Allahut dhe nuk mund të shkonte kundër vullnetit të Tij. Mund ta vrisja, mendoja, por ajo ishte në një klinikë private. Do ta kisha të vështirë të arrija tek ajo, sidomos të gjendesha vetëm me të. Fëmijët i qëndronin te koka me radhë çdo natë.

E përshtatshme mund të ishte ime shoqe. Po të isha disi frikacak, do të thërrisja engjëllin Azrael ta hiqte qafe. Asaj i zihet fryma në gjumë. Ai mjaft ta zgjaste ndërprerjen e frymëmarrjes një ose dy minuta dhe ajo do të jepte shpirt.

Ju pyesni përse dua të mbërrij në këtë pikë ekstreme me time shoqe? Ende e quaj gruaja ime, por në fakt kemi afro dy vjet që nuk jemi më burrë e grua. Pavarësisht nga kjo, ajo nuk më shqitet dhe kërkon të ma nxijë jetën.

Por, për fat të keq, nuk kam fuqi të thërras engjëjt, nuk jam i zoti të kaloj nga dëshira për ta parë të zhduket, te zhdukja e saj. Jam si gjithë të tjerët, parapëlqej t'i nënshtrohem fatit, rastësisë, kësaj lloj magjie virtuale që vepron një ditë në vendin tonë.

Kështu, më shkoi mendja te Lalla Zinebja, gjysmëmotra ime, dymbëdhjetë vjet më e madhe se unë. Ajo vuan nga shumë sëmundje: diabeti, tensioni, vështirësi në frymëmarrje, kolesteroli i lartë. Nuk ngrihet dot në këmbë, nuk ecën dot, qëndron ulur, lutet dhe pret që Allahu të vijë dhe ta marrë me vete. E pret, sikur Ai do t'i bjerë ziles së shtëpisë dhe me mirësjellje do t'i kërkojë të përgatitet për udhëtimin e fundit. Hap rregullisht perden e dritares për të parë nëse përpara portës është dikush i dërguar nga Allahu. Gjithnjë zhgënjehet. Jeta nuk i pëlqen më. Thotë se Allahu i ka dhënë kohë të martojë të gjithë fëmijët dhe nipërit dhe se misioni i saj ka mbaruar. Qëkur i ka vdekur i shoqi në një aksident, i ka humbur shija e jetës. Prandaj, ajo ishte një kandidate e përkryer për çlirimin tim. Por, për këtë, duhet të shkoja në Uazan, krahinë ku nuk hyn dot lehtë. Duhet të gjeja një shkas, për shembull, një ilaç që nuk ekziston në Marok, ose një dhuratë nga Meka. Ajo adhuron gjithçka që



vjen prej andej. E ka bërë pesë herë pelegrinazhin dhe mendon se s'të bie rasti të vdesësh në vendet e shenjta të Islamit. Mund t'ia kisha propozuar udhëtimin që ta shkelnin me këmbë ca harbutë dhe të vdiste menjëherë. Por nuk isha aq besimtar sa ta merrja këtë risk.

Shkova në Uazan. Mora me qira një makinë me shofer. Nuk e ngas dot makinën në Marok, ku njerëzit nuk respektojnë rregullat e qarkullimit. Ndërsa shoferi im dinte shumë mirë t'u paraprinte reagimeve të shoferëve të tjerë dhe të shmangte kështu aksidentet. Ishte i zgjuar, por racist i hapur, thoshte se nuk i donte hebrenjtë, as të zinjte, ndërkohë që lëkurën e kishte tepër të errët dhe mendonte se ishte normale të mos i lejonte të bijat të studionin jashtë vendit, as gruan të dilte lirshëm. Ishte kampion i teorisë së komplotit. Gjithçka e lidhte me intrigat e armiqve të islamit dhe të myslimanëve. U përpoqa t'ia ndryshoja mendjen, por më kot. Ishte aq i sigurt në bindjet e tij, sa më në fund, hoqa dorë nga lufta. Sidoqoftë, arrita ta ndaloja që në praninë time të fyente hebrenjtë dhe zezakët. Ai e përmbante veten, por e shihja se kjo e brente nga brenda dhe se bënte sforcime të mëdha.

Mbërrita në mesditë. Bënte vapë e madhe. Mendova se kjo do të më ndihmonte për ta çuar në atë botë. Para shtëpisë së saj, pashë një ambulancë. Ajo merrte frymë me zor. Iu hodha përsipër dhe, gjoja për ta puthur, peshova të gjithë trupin për të ndaluar frymëmarrjen. Vdiq para se të mbërrinte në spital.

Pyeta veten se sa ndihmë i kisha dhënë që të vdiste. Tridhjetë për qind? Pesëdhjetë për qind? Gjykova se pjesa ime ishte mbi pesëdhjetë për qind. Kjo më siguroi disa net me gjumë të thellë, të gjatë dhe sidomos të merituar.

Gjithsesi, qava për vdekjen e saj. Me lot të vërtetë. Nuk jam përbindësh. Më kujtoheshin gjellët që na përgatiste kur ktheheshim nga shkolla të uritur. Ishte e sjellshme. Me të vërtetë, nuk kishte aspak ligësi. Fëmijët e saj qanin dhe më përqaфонin, ndërsa unë përpiquesha t'i ngushëlloja, duke cituar vargje nga *Kurani*, ngaqë e dija se ishin tepër të dhënë pas atij libri të madh. Fshija sytë me shamitë që më zgjasnin. “Shpëtoi, - u thosha, - në parajsë do të jetë e lumtur, sepse nëna juaj ishte shenjtoreshë, jeta e saj do ta dëshmojë.” Falë pjesëmarrjes sime jo të parëndësishme në vdekjen e saj të papritur, nuk kishte asnjë fije dyshimi për hipokrizi. Megjithatë, e përsëris, e doja sinqerisht shumë.

Po atë darkë, me gjithë vapën dhe zërat hundore të kënduesve të *Kuranit*, fjeta si qengj, pa kurrfarë shqetësimi. Me shumë gjasë, nga krimi që kisha bërë, do të fitoja disa muaj gjumë. Por, ndërkohë, duhet të gjeja një zgjidhje rrënjësore për pagjumësinë. Gjithsesi, nuk mund të shndërrohesha në vrasës serial për të hequr qafe hallin që kisha. Duhet thënë se kisha bërë gjithçka që kisha mundur dhe kisha shpëtuar nga gabimet. A mund të thuhej për mua se isha bërë

vrasës? Çuditërisht, kjo nuk më pengonte të flija dhe me ndërgjegjen e gjeja fjalën lehtësisht. Në fund të fundit, nëna dhe motra ishin njerëz në grahamat e fundit. I mbushja mendjen vetes se u kisha shërbyer, se ua kisha lehtësuar vuajtjet, se kisha shmangur ato barnat lehtësuese, që shpesh nuk shërbejnë për asgjë. Natyrisht, kisha përshpejtuar fundin dhe i kisha dhënë një dorë kosës. Por nuk isha marrë me të rinj, as me njerëz aktivë, as me të huaj. Gjithçka ishte bërë me sqimë. Për çastin, veprimet dhe dozat nuk i kisha bërë i sforcuar. Nuk kisha përse ta fshihja veprimin tim. Puna ime - punë është? - nuk kishte lënë gjurmë. Atje kisha shkuar për të nxitur çastin përfundimtar.

### Kapitulli 3

Një mik egjiptian, përfaqësues i firmave farmaceutike, më kishte folur për një test që mund të kaloja lidhur me të sëmurët në fund të jetës, duke u mbajtur dorën dhe duke i ndihur moralisht për të dhënë shpirt. Kjo gjë m'u duk tërheqëse dhe pyeta veten nëse do të isha në gjendje të kisha aq qetësi për të shoqëruar njerëz të panjohur deri në vdekje.

Testi ishte vendimtar. Më caktuan në spitalin “Mohamed V”, një territor ku vdekja hedh valle me të sëmurë të pashpresë. Mbërrija të premtën pasi bëja pazarin, pyesja për dhomën e burrit a të gruas që ishte në grahmat e fundit. Infermierja shikonte një regjistër, pyeste kolegen e saj: “Beson vërtet se është fundi i Markezit? Apo mos është dita e zonjës Labish?”. Doja të dija përse më caktonin të huaj. Kur pyeta, infermierja më tha: “Ne myslimanët nuk i braktisim të sëmurët tanë; këtyre të huajve mjëranë nuk u vjen njeri për vizitë, prandaj ju çojmë tek ata”. Shumica e këtyre europianëve kishin zgjedhur Marokun për ta

kaluar pensionin në diell. Në fillim fëmijët u shkonin për vizitë, por, pak nga pak, lidhjet dobësoheshin dhe harresa vendosej butësisht.

Herën e parë që u gjeta në dhomën e atij që e quante veten Markez - një burrë me mustaqe të holla dhe me favorite si në Francën e qëmotit - ai ishte i pavetëdijshëm dhe, prej shumë kohësh, nuk kishte shkuar askush ta shihte. Infermierja më pëshpëriti në vesh: “Familjarët telefonojnë vetëm për të marrë vesh në ka dhënë shpirt apo jo, presin trashëgiminë...”.

Ia kapa dorën dhe ia shtrëngova; një dorë e madhe, e hollë, me vurrata të zeza, me thonj të paprerë prej kohësh. Qepallat e tij lëvizën. Sakaq, nisa t’i flisja. Dorën e kishte shumë të ftohtë. Ia ngula sytë te gjoksi. Nuk merrte më frymë. Thirra infermierën, që i mati tensionin, por ajo më tha: “Mos u gënjeni, nuk ka vdekur, jeton me rrahje të ngadalta, vazhdoni t’i flisni”.

Përfitova nga vizita e mjekut për t’u larguar. Gjysma e pulës, që kisha blerë në mëngjes, duhej të ishte ftohur. Do ta haja me mustardë dhe me ullinj dhe, po të më vinte gjumë, do të shtrihesha në shtratin tim. Ndoshta fakti që kisha qenë aq pranë vdekjes, do të më ndihmonte të flija. Ideja për të ngrënë gjysmën e pulës nuk më ndahej nga mendja. Te shitësi, pas meje, kisha vënë re praninë e një zonje të bukur rreth të pesëdhjetave, të veshur mirë, të lyer me sqimë. Ajo kishte blerë gjysmën tjetër. Sikur ta gjeja, do

ta ftoja për drekë në shtëpi. Do t'i vendosnim dy gjysmat njërën përballë tjetrës dhe do të hanim me oreks. Ndihesha i dërrmuar, fillikat në kuzhinë, duke u përpjekur të gëlltisja atë copë pule të ftohtë dhe jo shumë pikante. E njëjta gjë duhej të ndodhte edhe me atë. Por nuk u kryqëzova përsëri në rrugë me zonjën e bukur.

Kur u ktheva pasdite te dhoma e Markezit në spital, ia kapa dorën sërish. Dëgjoja frymëmarrjen e tij, por ajo ishte gjithmonë e më e shkurtër. A ishte ky fundi i tij? Në fillim të mbrëmjes pati konvulsione. Lajmërova përsëri mjekët. Ndërkohë që prisja mjekët ia shtrëngova fort dorën dhe e mbyta, me kokën e vendosur mbi gjoksin e tij. Kur hyri në dhomë mjeku rojë, dëgjoja një rënkim dhe pastaj asgjë. Ai e pa që kishte vdekur dhe e dërgoi në morg. Dola prej andej i lodhur dhe me zorrët te goja. Por fjeta mirë.

Të dielën tjetër, më besuan znj. Labish. Ajo vetëm ankohej. Mallkonte, por nuk kuptoja asnjë fjalë. Kur i kapa dorën, ajo e tërhoqi menjëherë. Kisha rënë te një njeri i pabindur. Pas një ore, e kuptova, më në fund, se nuk kishte aspak dëshirë të largohej nga kjo botë. Më kujtonte disa nga netët e mia të pagjumësisë. Ishte e shqetësuar, fatkeqe, e pakëndshme. Asnjëherë e qetë. Luftonte për të jetuar, ndërkohë që trupi e tradhtonte gjithnjë e më shumë. Më kishin thënë se donte ta thërrisnin Zonja Ambasadore. Ndërkohë, askush nuk e kuptonte përse dhe mendonin se fantazonte deri

ditën kur një doktor kishte pohuar se ajo ishte vërtet e veja e një ambasadori belg në Australi dhe se ishte fare në rregull nga trutë.

Natyrisht, atë natë nuk fjeta. Imazhi i asaj gruaje rebele ndaj paqes nuk më shqitej. Për shkak të saj vendosa t'u jepja fund vizitave dhe të falënderoja mikun egjiptian, duke i thënë se nuk isha aq i zoti për këtë punë.

Disa ditë më vonë u ndesha ballë për ballë me zonjën e gjysmës së pulës. Sikur të m'i kishte lexuar mendimet, u afrua dhe nisi të flasë:

- Jam vegjetariane. Të dielën, gjysmën e pulës nuk e bleva për vete, e bleva për Hishamin, vëllain tim të verbër, i cili jeton me mua.

E ftova për të pirë një çaj nenexhik pa sheqer. Ajo binte erë të mirë. Një çast, më pyeti nëse flija mirë. E çuditshme! E kishte pikasur që vuaja nga pagjumësia? Ia shtjellova rastin, sigurisht pa i folur për hilenë time. Ajo më rrëfeu se e kishte humbur gjumin që kur i shoqi i kishte vdekur papritur nga një pushim zemre. Sapo ishin martuar dhe kishin shumë projekte së bashku.

- Tani kujdesem për vëllain, është i zgjuar, por nganjëherë e humbet durimin dhe zemërohet.

Përgjigjja e saj më turbulloi. Harrova t'i merrja numrin e telefonit dhe i rashë shkurt takimit.

## Kapitulli 4

Që nga vdekja e Markezit pothuajse flija mjaft mirë, por e ndieja se kjo gjendje ishte e brishtë dhe se do të kthehesha sërish në gjendjen e mëparshme. Por, mrekullisht, Toni, një i njohur i vjetër, portier në klinikën “Jebilat”, më telefonoi një fundjavë. Emrin e vërtetë e kishte Ahmad, por e quante veten Toni, duke iu referuar Toni Montanës, mafiozit të filmi *Njeriu me shenjë*, luajtur nga Al Paçino.

- Eja shpejt, kupton, Pedofili, bastardi, që vrau motrën time të vogël, ka mbërritur në urgjencë i gjakosur nga një aksident ose zënkë, nuk e di, por është në gjendje të rëndë. Lajm i mirë, apo jo? Eja shpejt, është koha të përmbushim ëndrrën tonë... do t'i japim fund...

Në fakt, në Tanzhe, ishte një mësues rreth të dyzetave, shpirti zgjyrë i të cilit lexohej në fytyrë. E thërrisnin “Pedofili”, “Plaku” “Qorri me një sy”, madje edhe “Poeti”, por me njëfarë përbuzjeje. I dobët, thatim, me rrudha vertikale, me sy të ligj, me



një gojë pa buzë dhe me dhëmbë të krimbur, mbante syze qorri me xhama të trashë dhe pretendonte se i pëlqente poezia, sidomos poezia që shkruanin vajzat e reja naive, të gatshme të bënin çdo gjë, për t'iu botuar poezitë. Kishte hapur një gazetë me titullin e thjeshtë *Poezi*. Shkruante edhe vetë tekste pa shije, por mjaft të pakuptueshme për t'u shitur si poezi hermetike.

Gjuante të rinjtë - djem dhe vajza - kur dilnin nga kolegji dhe i joshte, u ofronte ndihmë për të shkruar. I shtynte të shkruanin poezi. Poezitë më të mira do t'i botonte në gazetë. I dallonte menjëherë ata që nuk e besonin dhe që i shmangeshin. Të tjerët binin në kurthin e tij si fiq të pjekur. Në studion e vogël, ku priste viktimat, zhvillohej një skenar i tërë. Muzikë, ndriçim i zbehtë, çaj nenexhik dhe, herë pas here, cigare hashashi që i tymosnin të shtrirë, të kapur për dore.

Malika, motra e vogël e Tonit, ishte një nga viktimat e para të tij.

Ishte një kohë kur në shtyp nuk flitej për pedofilinë, as për perversitete të tjera. Hipokrizia sociale heshte për këto drama. Pas takimit me të, vogëlushja Malika pësoi një depresion të papritur dhe më pas, një verë, u zhduk në një det të trazuar, ku kishte shkuar për të notuar. Ishte vetëvrasje.

Pas vdekjes së saj, i dërrmuar dhe pa pará, Toni më kishte kërkuar t'i gjeja një punë. Kështu, një mjek, të cilin e kisha mik, e kishte punësuar në klinikën e tij si portier, por në fakt, ai i bënte të gjitha punët.

“Pedofili”, siç e quante ai, ishte pa dyshim qenia më e neveritshme, më e pështirë, më e ndyrë, më e kalbur, më mizore, më e rrezikshme e mbretërisë. Vdekja e tij kërkohet çdo ditë në jo më pak se pesëdhjetë xhami në vend nga familjet fatkeqe, fëmijët e të cilave ishin abuzuar seksualisht. Arroganca dhe brutaliteti i tij kishin shoqe vetëm etjen e tij për të bërë keq. Ai gjithmonë vepronte buzagaz dhe nuk ndëshkohej. E qeshura e tij ishte e lyrshme dhe fryma kutërbim. Ende nuk ishte ngritur asnjë padi kundër tij. Turpi dhe fatkeqësia e familjeve mbyteshin në heshtje. Pedofili, dikur, i ishte sjellë vërdallë mbesës sime, një vajze romantike që shkruante poezi sentimentale, por të sinqerta. Rrugaçi i kishte kërkuar t’ia dërgonte tekstet dhe ajo kishte rënë në rrjetën e tij. Vëllai im i madh, i frikësuar, më kishte kërkuar ndihmë. Pedofili ishte i paprekshëm për sa kohë që nuk detyronte askënd t’i shkonte në shtëpi. Ky njeri trupvogël, thatim dhe servil, ia dilte të qëndronte i paprekur. Vetëm im vëlla kishte guxuar t’i bënte kallëzim penal këtij perversi që, si do ta merrnim vesh më vonë, mbrohej nga policia, sepse e informonte atë për disa kundërshtarë politikë të regjimit të Hasanit II. Padia kundër tij u mbyll shpejt me gjithë përpjekjet e një avokati serioz, i cili u detyrua të hiqte dorë, sepse Pedofili ishte informator i paprekshëm i regjimit.

Në Tanzhe, ai ishte i njohur për marifetet dhe perversitetin e tij. Vepronte pa rënë në sy. Disa prindër ishin përpjekur ta kërcënonin dhe kishin shkuar deri

atje sa kishin pajtuar një doker që t'ia thyente brinjët. Kur e kishte marrë vesh këtë gjë, ai ishte zhdukur për t'u vendosur në Tetuan, ku kishte gjetur viktima të reja, gjithnjë të rinj dhe, mbi të gjitha, të bindur, të cilët i mbante nën kontroll. Në Tanzhe, askush nuk fliste për të. E kishin harruar. Deri ditën kur Toni më telefonoi shumë i eksituar. Më në fund, kishte ardhur koha për të shpejtuar vdekjen e një pisi, që policia nuk e mbronte më. Epoka e viteve të dhunës politike i takonte së shkuarës.

Unë nuk ia kisha kërkuar kokën e tij Perëndisë në ndonjë xhami apo kishë. Nuk i isha drejtuar drejtësisë së korruptuar në të gjitha nivelet, nuk isha ankuar te familja e tij, as te spiunët e tij, nuk isha përpjekur ta fusja në kurth. Kisha mësuar vetëm të prisja me mjaft durim për t'u gjendur përballë tij tani që ishte më afër vdekjes sesa jetës. Në urgjencën e spitalit, Pedofili ndërkohë qëndronte shtrirë dhe gjysmë i vetëdijshëm. Vuante, rënkonte, nuk i hapte dot sytë, nuk thoshte dot asnjë fjalë, ishte i mbuluar me gjak. Kishte marrë fund dhe kisha besim se mjekimi do të vonohej dhe nuk do ta bënte efektin për shkak të gjendjes mjerane të infrastrukturës së klinikës dhe paftësisë së mjekëve rojë. Rasti i tij duhej të përkeqësohej tejmasë që të mos e zhvendosnin dot. Ashtu si të gjithë rrugaçët e mëdhenj, ai duhet të kishte sigurim jete europian, që mundësonte transportin me avion sanitar dhe kurimin në një spital parisian. Por, duke marrë

parasysh frakturat e shumta dhe mungesën e gjakut për transfuzion, ai rrezikonte të qëndronte në klinikë edhe për pak kohë. Do të vuante gjithë natën dhe shpresoja që gjatë agonisë të mos i hiqeshin nga kujtesa të gjitha vajzat e reja, të cilat i kishte shfrytëzuar, përdhunuar, shantazhuar në mënyrë të neveritshme. Fytyrat e tmerruara të prindërve të shqetësuar, disa me një thikë kuzhine, të tjerët me një pishtar të ndezur, do ta kërcënonin në orët e tij të fundit. Do të parakalonin ngadalë, do të përkuleshin mbi të dhe do ta pështynin në fytyrën e shpërfytyruar. Do ta kishte të vështirë ta gjente gjumin, qoftë edhe një herë të vetme, ai që zakonisht dremiste pa problem, pa merak, pa ngurrim, sapo ta vinte kokën mbi jastëk.

Familja dhe miqtë e tij të paktë, të ardhur nga larg, nuk ishin lejuar ta takonin, për ligjur kjo nga gjendja e tij shumë e rëndë. Ai ndodhej vetëm në reanimacion. Në mesnatë, pritej të vinte mjeku kirurg që po mbaronte darkën në një dasmë të madhe. Pedofili kishte humbur ndjenjat, po vdiste. Infermierja u përpoq të lidhej me mjekun, por ai kishte ngecur në trafik. Karvani i dhëndrit dhe nuses kryqëzohej me një karvan tjetër dhe buritë binin pa pushim. Infermierja nuk dëgjonte asgjë.

Në orën një të mëngjesit, veshi një bluzë të bardhë mjeku, që ma kishte dhënë Toni, dhe hyra me kujdes në reanimacion, me një maskë bojëqielli në fytyrë. Në korridore, të gjithë më morën për kirurgun që prisnin. Ndërkaq, m'u kujtuan fjalët e Alfred Hitchcock-ut

lidhur me krimet: “Është shumë më e vështirë nga sa mendohet të vrasësh dikë me duart e tua. Kjo është betejë, luftë e pasigurt dhe shpesh e kotë. Njerëzit vdesin lehtë vetëm në filma. Në jetën reale, është e pamundur të shpresosh të mbysësh një njeri sado trupvogël qoftë”.

Iu afrova te fytyra, i pëshpërita në vesh se ora e tij kishte ardhur dhe se isha tejet i lumtur që ma kishin ngarkuar mua këtë gjë. Nuk pata nevojë të përleshesha. Ai nuk lëvizte më, por dëgjonte. I thashë emrin tim dhe të dy viktimave të tij. Pastaj, i shtypa plagën më të madhe. Ai lëshoi një klithmë, të cilën e mbyta aty për aty me një leckë, që ia futa në gojë. Duke peshuar mbi të, ia hoqa tubat pa rënë në sy. Atij nisi t’i merrej fryma. Frymëmarrja u bë e vështirë dhe e ngadaltë, aq e ngadaltë, sa do të ndalonte në mënyrë të pashmangshme për pak minuta, kohë për mua që t’ia vendosja tubat pa më parë e dëgjuar kush dhe për të dalë në rrugë nga dera e morgut, ku nuk kishte njeri.

Kur dola nga klinika, pashë kirurgun që po vinte i veshur me smoking dhe papijon. Shtirej sikur nxitonte për të parë të sëmurin. Nga larg, i ulur në makinë, prita vazhdimin e ngjarjeve. Një çerek ore më pas, pashë familjen e tij që doli e pikëlluar, duke qarë e bërtitur. Portieri përpiqej t’i qetësonte. Njëri nga vëllezërit ulërinte se do ta padiste atë klinikë jokompetente, të paaftë për t’i dhënë ndihmën e parë një njeriu të mjerë, të plagosur. Sulmonte Marokun dhe sistemin e tij shëndetësor, kërkonte që të bëhej

gati menjëherë një avion për ta transportuar të vëllain në Malaga, njëzet minuta larg, ku kishte mjekë të mirë, jo të paaftë, jo mjeranë dhe vrasës... shante, i binte me shkelma makinës, mbante kokën me duar dhe ndoshta qante nga inati dhe dëshpërimi. Ishte tepër vonë.

Shfaqja ishte e mrekullueshme. Një shfaqje teatrore si e Xherit. Fati ishte zgjuar me vonesë, por, më në fund, kishte triumfuar mbi Pedofilin. Unë isha tepër i lumtur dhe fërkoja duart dhe sytë. Nxora nga kutia e dorashkave një shishe të vogël birre dhe rrëkëlleva disa gllënjka. Isha i sigurt se ai vemja do të kalbej për një kohë të gjatë para se brejtësit e varrezës të nisin me eshtrat.

Pa ngrënë darkë, u shtriva në shtrat i veshur dhe ia futa gjumit top për një kohë të gjatë. Madje, besoj se urinën e bëra në shtrat. Ia vlente.

## Kapitulli 5

Që nga kjo ngjarje, Toni flinte shumë keq. Erdhi të më fliste për këtë gjë, ndërkohë që po bëhesha gati të merrja një sy gjumë pasdite nën pemën njëqindvjeçare të kopshtit. Nuk ishte i qetë, kishte brenga, keqardhje, fliste për Allahun dhe profetin e tij, për ferrin dhe për frikën se mos shkonte atje.

Më pyeti në flija mirë. E vështrova dhe i thashë buzagaz “po, tani shumë mirë”. Nuk kisha dëshirë t’i shpjegoja sa mirë ndihesha nga zhdukja e disa njerëzve dhe e qetësova duke i folur gjatë:

- Nuk ke pse të kesh brenga për Pedofilin, gjithsesi, i kishte ardhur ora për t’u larguar. Ne nuk kemi punë me këtë gjë, ishte e shkruar. Përkundrazi, vdekja e tij duhet të na gëzojë. Kujto çfarë i ka bërë motrës sate të vogël dhe si i ka shpëtuar për vite me radhë drejtësisë... Edhe vëllai im i madh është lehtësuar. E kishte ndryrë këtë histori që kur martoi të bijën, por prapë plagë e kishte. Vajza e ka rindërtuar jetën, pavarësisht nga trauma e përdhunimit. Të flasësh për viktimat gjithnjë është e vështirë. Turpi dhe faji bashkohen, të bëjnë të

heshtësh dhe ngjarja, me kalimin e kohës, struket në një cep të kujtesës, por nuk fshihet.

Toni, për një çast, sikur u bind. Dukej që ishte më mirë. Por, kur po largohej, më kapi në befasi dhe më tha se tani e tutje duhet të merreshim me vëllanë e tij, i kërkuar nga disa polici për trafik droge.

I habitur nga kjo kthesë e papritur, bëra një gjest me dorë për t'i thënë se nuk më interesonte. Por sytë e tij nisën të ndrisnin, sikur krimi të kishte filluar t'i shijonte. Me sa dukej, fjalët e mia e kishin çliruar dhe ndihej i gatshëm për hakmarrje të reja.

Një javë më pas, erdhi e më takoi sërish, me pamje të shqetësuar, pre e një krize paniku. Me gjasë kishte ardhur me vrap, sepse i merrej fryma:

- Çdo natë, Pedofili më bën vizitë dhe më kërcënon se do të hakmerret. Jam gjithnjë e më i frikësuar. Sidomos, pasi kirurgu dyshon se e kam njoftuar me vonesë nëpërmjet infermieres dhe fajin për këtë ma hedh mua. Nuk e di se kush ia ka futur në kokë këtë mendim, por më mbajti një fjalim të çuditshëm.

Sa më shumë përpiqesha ta qetësoja, aq më shumë vëreja se ishte i brishtë dhe përbënte rrezik për mua. Nuk e kontrollonte dot veten dhe e përfytyroja mjaft të aftë për t'ia rrëfyer historinë tonë policisë. Vendosa ta gënjeja.

- Ti e di, kur hyra në reanimacion, rrugaçi nuk mernte më frymë, kishte vdekur ndërkohë. Kur e vura re, po ta them, u ndjeva shumë keq dhe dola nga



dera e pasme e morgut. Isha i lumtur dhe i zhgënjyer njëkohësisht. Por Allahu i kishte përshpejtuar gjërat. Pra, hiqe nga mendja, nuk e kemi vrarë ne.

Ai ishte pak i lodhur, bënte ecejake, ndezi një cigare dhe nisi ta thithte me nervozizëm. I kujtova se e kishte lënë duhanin. Ai ngriti supet, sikur do të thoshte se duhani ishte më i fortë se ai.

## Kapitulli 6

Ish-gruaja ime nuk e ka njohur kurrë pagjumësinë. Gjithmonë ka fjetur mirë, e ka bërë gjumin top dhe për një kohë të gjatë. Sa herë e kam vërejtur duke marrë frymë dhe madje duke buzëqeshur, larg shqetësimeve të mia?

Ajo i beson natyrës. Ka teori për çdo gjë dhe bimë për t'i pirë si çaj për gjithçka. Asnjëherë ilaçe. Asnjëherë mjek. Mjekohet vetë. Ushqehet bio. Natyrisht, është vegjetariane. Është e dobët, lëkurën e ka shumë të bardhë, shumë të çelur. Sytë blu i japin hijeshi buzëqeshjeve të saj. Gjatë natës flinte në pafajësi të plotë. Të nesërmen më mbante leksion. Më kot i thosha se historia dhe e kaluara ime ishin të ndryshme nga historitë e saj, por nuk donte të më besonte.

Guxonte të më thoshte: “Të flesh, mjafton të kesh dëshirë”.

Këtë fjali ma ka përsëritur aq shpesh, sa nuk mund ta dëgjoj më. Dëshira! Sikur të hyja në dhomë me dëshirën për të puthur pagjumësinë.

Pagjumësia e ka shkatërruar marrëdhënien time martesore. Për shkak të saj, fjetëm në dhoma të veçanta dhe nuk bëmë më dashuri. Ndoshta nuk ishte vetëm për shkak të pagjumësisë. Shkaku duhej kërkuar gjetiu. Hoqëm dorë nga dashuria shumë herët. As ajo, as unë, nuk u përpoqëm ta mbanim, t'i jepnim një shans të dytë. Net të tëra kam pyetur veten. Përse na la dashuria? Ndoshta ngaqë e kishim mbivlerësuar dhe se ishte shumë më e dobët nga sa besonim. Pastaj, nuk bëmë asgjë për ta konsoliduar, forcuar, ripërpunuar dhe u përshtatëm me formën e saj të re.

Megjithatë, në fillim të jetës bashkëshortore, flinim të përqafuar, të dashuruar. Në mëngjes nuk kishim të njëjtin ritëm. Unë ngrihesha herët, dëgjoja radion në kuzhinë, bëja gjimnastikë, përgatisja çajin dhe dy feta bukë të thekura. Netët dhe ditët tona ishin të bukura, normale, për t'u pasur zili.

Pagjumësia e parë ndodhi më 10 dhjetor 1987. Ime shoqe ishte larguar pa më paralajmëruar dhe pa më njoftuar. Askush nuk e dinte se ku kishte shkuar. Nuk më zinte gjumi, isha shumë i shqetësuar. Mos vallë ishte zhdukur dhe, si në filmat amerikanë, policia do të më telefononte për të identifikuar trupin? Mos vallë thjesht ishte larguar për t'u argëtuar, pa më thënë gjë? Mos kishte ndonjë të dashur?...

Si mund të flija me të gjitha këto pyetje pa përgjigje? U shtriva në shtrat me shpresën për t'u qetësuar, por pamje tejet të këqija vinin dhe më mësynin. Herë e

shihja në krahët e dikujt tjetër, herë në një ambulancë. Nata ekzagjeronte gjithçka. Zhurma e një makine kishte madhësinë e ngritjes së një *airbus*-i. Lehja e një qeni shndërrohej në ulërimë. Duhet të bëja diçka. U ngrita. E dija se mania për të vendosur rregull do të më pengonte të mendoja. Por ja që rashë në një artikull të gazetës *Le Monde*, që fliste për njerëzit që zhdukeshin çdo vit pa u rishfaqur kurrë. Madje, një shoqëri u ofronte shërbimet e saj individëve të veçantë, për ta bërë këtë lloj ndarje shumë të veçantë. Ndalova së vendosuri rregull. *France Musique* jepte një muzikë tepër të trishtë. Ndërrova stacion. Nino Ferrer-i këndonte historinë e së fejuarës së tij, e cila merr një avion që nuk mbërrin kurrë. Komplot! Gjithçka ishte kundër meje dhe më dënonte të kaloja një natë shumë të keqe. Gjumi më zuri rreth orës shtatë. Në orën tetë, trokiti dera. Duhet të ishte policia që kishte ardhur për të më njoftuar për ndonjë fatkeqësi.

E hapa, ishte ime shoqe, rrezatuese, me një qese me kruasanë në dorë.

- Ku ishe?

- Në klub nate!

Që atëherë, pagjumësia është ulur këmbëkryq brenda meje. Natën tjetër piva një gotë ujë, hapa një libër dhe nisa të mendoja diçka tjetër. Vështirë të kërkoresh gjumë pranë një personi, të cilin e përkëdhel nata. Net të tjera të ngjashme me atë të 10 dhjetorit kanë qenë të shumta. Çdo herë përligjja ishte e ndryshme. Një avari në autostradë. Një mbesë e vogël, e shtruar

urgjentisht në spital. Prindërit e kthyer nga Meka. Një mikeshë e braktisur nga burri. Por asnjëherë asnjë telefonatë.

Neglizhencë, harresë, shpërfillje, apo përçmim ndaj njeriut që ajo e akuzonte se e tepronte me shqetësimet e tij?

Sot jetoj vetëm, fle vetëm, më saktë, shkoj vetëm në shtrat. Nuk fajësoj askënd për zhurmat dhe shqetësimet e mia. Të mos flesh, do të thotë të mos shohësh ëndrra. Por kam nevojë për ëndrra që të ushqej imagjinatën. Ëndrrat janë të çuditshme dhe nganjëherë të mësojnë diçka, sidomos kur i kalon në një sitë të imët. Pavetëdija ime është po aq e gjallë dhe aktive sa vetëdija. Ajo ka të drejtë të ketë hapësirë për t'u shprehur. Nata dhe gjumi janë territori i saj.

Pagjumësia nuk e lë të bëjë jetën e vet. Ia vjedh, e keqtrajton, lufton kundër të vërtetave që mund të na zbulojë. Puna e pavetëdijes është pjesë e ekuilibrit tonë, e harmonisë sonë dhe hap rrugët për lulëzimin tonë, por aty më është mohuar e drejta. Net të bardha, net të thata, pa ëndrra, pa makthe, pa aventura. Net të trishta. Net të kota, meskine, të katandisura në disa vuajtje. Net të padobishme, pa interes, pa aromë. Net për t'i harruar, për t'i hedhur në kazanin e plehrave. Net të pabesa. Net të pacipa. Net banditësh, mafiozësh, bastardësh. Net të pista, perverse, mizore dhe të pështira. Net të padenja për ditën, diellin, dritën dhe bukurinë e botës.

## Kapitulli 7

Ime shoqe zhdukej, pastaj shfaqej përsëri. Në fakt, kisha shumë kohë që nuk dija çfarë të bëja me të. Në atë kohë, nuk do ta kisha imagjinuar kurrë se një ditë do të më shkonte ndër mend ta vrisja. Ajo do të kishte luftuar si hienë. Ka energji të jashtëzakonshme, një forcë të tmerrshme dhe një përbuzje tejet të madhe për të drejtën dhe ligjin. Sot do të isha unë nën dhé po ta kisha sulmuar. Mandej, më kishte paralajmëruar: “Një ditë do të të shkatërroj”. Ajo ishte zhdukur nga perimetri im, por hija e saj nuk më ndahej gjatë gjithë kohës, sidomos natën. Aftësia e saj për të mos më lënë të qetë mbetej e paprekur. Kur përpiquesha t’ua shpjegoja këtë të afërmve të mi, mendjet e marra më thoshin: “Sepse të do gjithnjë!”. Si mund ta ngatërronin dashurinë me dëshirën për të mos më lënë të qetë? Si mund të mendosh se të duash do të thotë të ngacmosh, ta hash me lënjë dikë që e ke pasur të afërt?

Por, në thelb, vendimin për ta hequr qafe e kisha marrë shumë kohë më përpara, thjesht nuk dija si të veproja dhe sidomos që të mos bija në duart e policisë.

Dy vjet pas ndarjes, a nuk kishte ardhur, më në fund, koha për të vepruar? Duhej kryer “krimi i përkryer”. Pashë përsëri filmin e Hitchcock-ut, por historia e bashkëshortit makiavelist nuk ishte e vlefshme në të gjitha rastet. Për të mundur pagjumësinë duhet të veproja vetë. Nuk mund ta delegoja si te Hitchcock-u. Ky ishte kushti thelbësor për të rigjetur gjumin.

Magjia, partizane e madhe e së cilës ishte ime shoqe, do të më ndihmonte të gjeja një dredhi të vyer. Por, për këtë, më duhej të depërtoja në atë univers arkaik, të konsultohesha me një sharlatan, të shtiresha sikur u besojta doktrave të tij dhe ta bëja atë të punonte kundër saj.

Nuk isha krenar kur pranova këshillën e dr. F., mik fëmijërie, për të shkuar në shtëpinë e një magjistari, të cilit i kuronte gjithë familjen.

Një zyrë e vogël, një burrë i imët me qelebie të vogël, me sy të vegjël, me buzën vesh më vesh. Digjte temjan, që duhet të ishte prodhuar në Kinë, dhe konsultonte shpesh një libër të madh në arabisht, jo *Kuranin*, por diçka të frymëzuar prej tij. Më kërkoi t’i germëzoja emrin. Në vend të emrit, shkroi mbi letër numra. Emri im ishte 26 48 52. Një numër telefoni i mëparshëm, ose ndonjë dosje e shërbimeve të fshehta. U kthye nga mjeku dhe i tha:

- Më jep emrin e kundërshtarit.

Pamë njëri-tjetrin në sy dhe germëzuam emrin e gruas sime. Një shifër më e vogël u shfaq: 22 36.

Magjistari ngriti sytë dhe duke psherëtirë tha:

- Shoh një grua, që e këshillon dhe e zotëron. Ajo është e fortë, shumë e fortë. Duhet të kalojmë në një fazë tjetër. Ajo ka kohë që gërmon varrin tuaj, e ndihmojnë tre magjistarë, njëri është në Agadir, tjetri në Tafraut dhe tjetri endet mes Marrakeshit dhe Tanzheit. Ata punojnë gjithnjë nën urdhrat e saj. Shumë pará, dhurata, vakte madhështore... Ajo është e pamposhtur. Më vjen keq, do të kisha dashur t'ju ndihmoja, por këtu kemi të bëjmë me vështirësi të mëdha, shumë të mëdha. Këshilla e vetme që mund të jap është që 26 48 52 të largohet prej saj mundësisht sa më shpejt, të jetë i paarritshëm, sepse ajo do ta ndjekë derisa të marrë atë që kërkon. Rrallëherë kam pasur rast të ngjashëm, 22 36! Është bombë, tërbim, egërsirë. Kini kujdes, ndërroni shtëpi, madje edhe qytet dhe mos i tregoni askujt ku jeni. Ajo do të godasë pa mëshirë. Është e vendosur t'ju shkatërrojë me çdo mjet. Nuk do të heqë dorë kurrë nga preja e saj, është kokëfortë, pa parime, e pamëshirshme.

Pasi heshti një çast, shtoi:

- Ajo nuk është njerëzore, ka jetuar me kafshë të egra, nga të cilat ka trashëguar pangopësinë dhe kafshërinë.

Kur dolëm nga ky takim shoku im kishte më tepër frikë sesa unë. I kishte marrë shumë seriozisht fjalët e magjistarit. Për mendimin tim, magjistari vetëm kishte konfirmuar bindjet e mia. Problemi im nuk ishte zgjidhur ende. Ai ishte treguar i paaftë të na tregonte



si ta hiqja qafe time shoqe dhe si të shpëtoja lëkurën. Më këshillonte të largohesha, të ikja, të ndryshoja jetesë... Ishte e vështirë dhe shumë e paqartë.

Po atë mbrëmje, u përpoqa të ngrija një kurth për të larë hesapet me të. Në orën tre të mëngjesit, ende nuk kisha gjetur asgjë, por tashmë e kisha thyer natën. Kjo më brente shumë, duhej të mos mendoja më për këtë gjë, ose të pajtoja një vrasës profesional për ta bërë atë punë, por pastaj vdekja e saj nuk do të më ndihmonte në luftën kundër pagjumësisë. Përsëri sillesha vërdallë. Ta vrisja vetë, ishte shumë e rrezikshme. Nuk më mbetej veç të qëndroja sa më larg saj, ashtu si më kishte këshilluar magjistari, të mos e provokoja, të blindohesha dhe të mblidhesha kruspull. Ndoshta ky qëndrim, më në fund, do ta nxiste gjumin. Këtë u përpoqa të bëja atë natë. Por si të mblidhesha kruspull? Hapa një fjalor. Asnjë skemë, asnjë vizatim. Shkova në shtrat, palosa gjunjët dhe i tërhoqa nga vetja për të mbledhur kruspull shpinën. Kisha frikë nga ndonjë ngërç. Ndieja herë pas here të më kalonin përsipër diçka si hapa njerëzish. Duroja dhe nuk lëvizja. Ata duhet ta merrnin vesh se nuk më bënë dot gjë. Gjumi, në fillim, ishte disi i veçantë, pastaj trupi e pranoi atë pozicion dhe, më në fund, fjeta pothuajse mirë, duke menduar më shumë për shpinën sesa për gruan. Në mëngjes u zgjova i lehtë. Dukej se dëshira për hakmarrje ishte zhdukur. Nuk mendoja më për të. Shpina e mbledhur kruspull! Pozicion i mirë për të injoruar gjithçka.

## Kapitulli 8

Mendimi për të kryer një vrasje të dyfishtë më lindi atë natë të çuditshme. Dy vëllezër mbi të tetëdhjetat vuanin nga e njëjta sëmundje, Alzheimer. I njihja shumë mirë prej kohësh, sepse njëri nga djemtë e tyre ishte martuar me një kushërirën time. Si nuk më kishte shkuar mendja më parë?

Të dy vëllezërit kishin tre vjet pa u takuar kur, me afrimin e Ramazanit, familja e tyre organizoi një festë dhe i ftoi që të dy. Më i madhi, i cili jetonte në Malaga, mbërriti te shtëpia e të vëllait. Ishte i përhumbur, mezi ecte, u ul përballë vëllait. Herë pas here, më vështronte mua. Por ata nuk flisnin me njëri-tjetrin, sepse nuk njiheshin. Secili pyeste se kush ishte plaku tjetër përballë. Njërit prej tyre i dridhej dora. Nuk kishte asnjë shprehje në fytyrë. Kishin harruar që kishin qenë të afërt, se kishin pasur mosmarrëveshje, grindje, kishin luajtur bashkë, kishin ndarë aventurat dhe shumë dashuri vëllazërore. Çdo gjë ishte fshirë pa e kuptuar. Nuk dinin çfarë u kishte ndodhur. Megjithatë, ndërkohë luanin me

njëri-tjetrin. Pjesëtarët e familjes, të pranishëm në atë skenë, nuk dinin çfarë të thoshin. Nuk ishte vendi për t'u ankuar. Disa ishin të trishtuar, të gjithë ndiheshin të zënë ngushtë. Çfarë duhej bërë? Çfarë duhej thënë? Unë, thjesht i ftuar nga kushërira, e ndiqja atë skenë dhe mendoja se vdekja e tyre nuk do të vononte. Nuk është Alzheimeri që vret, mendoja, janë pasojat. Trupi rrëgjohet ngadalë pa e kuptuar. Mbetet karkalla, por mendja ka marrë arratinë.

Dy vetmi të mëdha përballeshin pa shkëmbyer asgjë me njëra-tjetrën. Më të madhit nuk i kishte ecur mbroth në jetë. Përkundrazi, vëllai i vogël, pothuajse analfabet, ishte i pasur. I ishte dashur disa herë të ndihmonte vëllain e madh. Por sot pyeste veten pa pushim se cili ishte ai burrë që e vështronte dhe për të cilin nuk dinte asgjë. Rregullonte syzet, kollitej, pinte një gllënjë ujë dhe pastaj zhytej në botën e tij. Me sa dukej nuk vuante.

Skena zgjati minuta të tëra. Na sollën çaj dhe ëmbëlsira. Ata pinë dhe hëngrën me oreks. Nuk e shikonin më njëri-tjetrin, ishin shumë të zënë me gëlltitjen e gurabijeve.

Papritur, një nga fëmijët pyeti të atin:

- Nuk e njeh atë?

- Jo!

- Është vëllai yt, xhaxha Abdelhamidi.

- Oh, po, paskam një vëlla dhe askush nuk ma ka thënë!

- Ky është vëllai, të cilit shpesh i ke dhënë shumë pará borxh.

- Pará? Kur?

- Nuk të kujtohet? Ka grua kunatën tënde; u bë dasmë e madhe; dy vëllezër që martoheshin me dy motra.

- U martova me motrën time? Ti je djall!

Kjo mund të kishte vazhduar kështu për një kohë të gjatë dhe të kthehej në situatë absurde dhe groteske, por një grua, ndoshta vajza më e madhe e më të riut, mori fjalën:

- Babai im ka grumbulluar tonelata me pará. Gjithë jetën i është përkushtuar biznesit. Kur ishte ende mirë me shëndet, nuk dinte sa pasuri kishte, kudo ka shtëpi, fabrika, tokë, dyqane, aksione në bankë. Pastaj, ishte koprrac, koprrac i madh. Nuk nxirrte asnjë qindarkë nga dora, duhet ta mashtroje për t'i marrë ndonjë kacidhe. Tani, të gjitha këto pará nuk i duhen fare. Nuk di ku gjendet dhe është bërë për mëshirë!

Vëllai i tij, jo aq i pasur, ishte në të njëjtën situatë. Dikush guxoi të tallej me të:

- Me Alzheimer të paktën i harron borxhet që ka; nuk e çan kokën, ha, pi, gromësin dhe fle pa marrë asnjë ilaç gjumi!

Për të ndërruar bisedë, djali më i vogël ia hodhi fajin mjekësisë dhe ilaçeve, akuzoi pikërisht qetësuesit dhe ilaçet e gjumit. Nëna plakë, e cila nuk ishte letuar ende, e përmbloodhi situatën:

- Më përpara kujtesa na bënte naze. Sot, me të gjitha këto barna, zhduket plotësisht. Kjo është arsyeja përse nuk kam marrë kurrë ilaçe. Kur dua të fle, i lutem Allahut dhe fle si qengj.

Një nga nipat e njërit prej vëllezërve pyeti pak me naivitet se si mund të parandalohej sëmundja e kujtesës.

Gjyshja përsëriti:

- Duke iu lutur Allahut.

I ati:

- Duke bërë fjalëkryqe.

Vëllai i tij i madh:

- Duke bërë ushtrime mendore.

Të tjerët vazhdonin bisedën, kishin harruar se dy vëllezërit e sëmurë ishin ende atje, ballë për ballë, pa ditur se ku ose me kë. Papritmas, një fëmijë lëshoi një klithmë. Të dy burrat kishin urinuar pa vetëdije. Një lëng i verdhë derdhej vilar në dhomën e ndenjjes. Ishte koha për t'i larë në banjë. Dy burra i morën dhe askush nuk foli më për ta. Skena kishte marrë fund. Një ndjenjë turpi dhe bezdie mbretëronte në shtëpi. Pa guxuar ta shprehnin, të gjithë shpresonin se një vdekje e ëmbël do t'i shpinte të dy pleqtë në një botë tjetër, larg zhurmës dhe tërbimit të të gjallëve. Por vdekjes nuk i pëlqen t'i lutesh kaq shumë, nuk nxitohet.

Disa javë pas kësaj feste, burri i kushërirës më pyeti nëse mund ta zëvendësoja në turnin e tij të rojës pranë të atit. Duhet të shkonte disa ditë në Spanjë për tregti. Më tha se ishte shumë e thjeshtë dhe se duhet të shkoja në fund të pasdites, nga ora gjashtë deri në nëntë, kur e shtrinin në shtrat dhe fiknin dritën. Ditën e parë kisha shumë emocione. Duhet të gjeja mënyrën e duhur për ta çuar në botën tjetër pa ngjallur dyshime.

Rreth orës shtatë e gjysmë, kuzhinierja solli supën, të cilën propozova t'ia jepja vetë plakut. Të nesërmen, e ushqeva përsëri, por, si pa dashje, ia fusja lugën paksa më thellë në gojë dhe atij vazhdimisht ushqimi i shkonte keq. Pastaj, ai nisi të kollitej me sa fuqi që kishte. Nuk e nxirrte dot lëngun që i kishte shkuar keq. Dola dhe kërkova ndihmë. E gjithë familja e pranishme erdhi me vrap. Sakaq, ai kishte dhënë shpirt. Menjëherë u shfajësova, u thashë se më kishte kërkuar më shumë supë dhe se lëvizte në shtrat, çka kishte shkaktuar aksidentin. Si pritej, askujt nuk i shkoi në mendje të më akuzonte. Përkundrazi, familja shikonte atje një çlirim.

Për mua, ky gjest fatal më mbushte, mund të flija përsëri.

Nuk mund të bëja të njëjtën gjë me vëllain e pasur, por më lindi një mendim. Një muaj më pas, u propozova djemve të tij, të cilët i njihja disi, t'i bënim një shëtitje me *Bentlin* e tij që mykej në garazh. Plaku ishte i lumtur që largohej nga shtëpia dhe sidomos që ishte i shoqëruar. Më pyeti për familjen, origjinën dhe nëse isha hebre. Unë i thosha jo, por kjo nuk i pëlqente. Donte që të isha hebre. Pasi më pyeti nja dhjetë herë, më në fund, i mërzitur, i thashë po. Sakaq, i zëmëruar, më ulëriti: “Po *kipan* ku e ke? Pse nuk e mban? Je çifut i keq, mysliman idiot!”.

Shprehja “mysliman idiot” në gojën e tij ishte fyerje. Ai më tha: “Po të mos ishin hebrenjtë, nuk do

të kisha bërë kurrë biznes. Ata janë të shkëlqyer dhe tela të përdredhur, por edhe unë duhet të kem gjak hebre, sepse unë jam më tel i përdredhur se ata. Kjo është arsyeja përse merreshim vesh mirë. Që kur janë larguar, ndihem shumë i vetmuar. Ç'patën që na braktisën kështu?". E ngisja makinën ngadalë dhe i tregoja peizazhet e Malit të Vjetër, ku ai kishte në pronësi disa hektarë truall për ndërtim. Nuk mbante mend asgjë. E zuri gjumi. Ndalova makinën, u përpoqa butësisht ta zgjoja. Kishte rënë në gjumë të thellë. Atëherë vendosa ta çoja në shtëpi dhe ta shtyja për më vonë realizimin e projektit tim. Sidoqoftë, me vdekjen e vëllait të tij kisha mbledhur një numër të madh netësh të garantuara pa pagjumësi. Kisha kredite dhe mund ta shtyja aksionin.

Fëmijët ishin të lumtur që kujdesesha për babanë e tyre. Më i madhi më thoshte:

- Gjithsesi, jam apo nuk jam këtu, ai nuk mban mend dhe më ngatërron gjithmonë me një nga klientët e tij, me të cilin ishte i zemëruar. Faleminderit për kohën që keni harxhuar me të!

Natyrisht, nuk mund t'i tregoja arsyen e vërtetë të pranisë sime. Kisha shpikur një histori për të përligjur vizitat duke u thënë se, kur isha student, ai më kishte ndihmuar, kishte paguar fshehurazi tarifën e regjistrimit. Fëmijët e tij kishin ngelur shumë të habitur, pasi koprracia e babait të tyre ishte legjendare.

Më në fund, një natë, i mjeri njeri ra nga shtrati dhe theu qafën e femurit. Djemtë më thirrën herët

në mëngjes për t'i ndihmuar të gjenin një klinikë të mirë. Mendja më shkonte te klinika ku kishte vdekur Pedofili, por, për siguri, ishte e nevojshme të ndryshohej vendi. I telefonova dr. F., mikut tim, i cili, pa e vizituar, më tha se me moshën që kishte nuk i mbetej më shumë se një javë jetë.

Pas shtatë ditësh, gjendja e tij ishte përkeqësuar vërtet shumë dhe pritej që të vdiste së shpejti. Duhet të ndërhyja patjetër, përndryshe nuk do të përfitoja asgjë nga zhdukja e tij. Shkova në darkë te klinika, ku ishte transportuar në fillim të javës. Dr. F., që punonte atje, erdhi të më përshëndeste. Më dha lajme për pacientin. Iu luta të më lejonte ta takoja plakun për herë të fundit.

- Nuk e ke as baba, as gjysh! - më tha si paksa me ironi, sepse, pa dyshim, shqetësimi im i dukej i çuditshëm.

- Mos u shqetëso, më lër thjesht t'i mbaj dorën dhe t'i flas, kjo e ndihmon të largohet në paqe butësisht.

Disa çaste më pas, hyra në dhomën e tij. U afrova te shtrati, ia vendosa dorën mbi fytyrë dhe, pa u sforcuar, e pengova të merrte frymë. Dhjetë minuta më vonë, thirra Dr. F., që konstatoi se kishte vdekur, i telefonoi familjes dhe më falënderoi për zemërsisht për praninë time, që, sipas tij, kishte qenë e dobishme për atë njeri. Shtoi, jo pa keqdashje, se fëmijët e tij do të ishin ndërkohë të lumtur.

Pikët e krediteve të gjumit - kështu i quaja tashmë - që po fitoja, ishin dhjetë herë më të rëndësishme



se ato që kisha fituar nga i vëllai, sepse për shkak të varfërisë së tij nuk kishin shumë peshë në bilancin e qeses sime imagjinare. Mund të dëgjoja edhe zhurmën tërheqëse që bënin kur binin te qesja ime e vogël. Për t'u qetësuar dhe për të përfituar, vendosa të shkoja dhe të mbyllesha disa ditë në një shtëpi, në mal, për të dëgjuar me vëmendje të gjitha regjistrimet e John Coltrane-s.

## Kapitulli 9

Para se të largohesha shkova te varri i nënës. Varreza ishte në gjendje të mjeruar dhe plot me plehra. Jashtëqitje të thara. Ushqime të kalbura. Të vjella. Mace dhe qen të egër që ziheshin për këto mbeturina. Shishe plastike të panumërta. Asgjë që të të krijojë dëshirën për t'u rikthyer.

U dhashë ca të holla disa lexuesve të *Kuranit*. U kërkova të shkonin të lexonin mbi një varr përballë varrit të prindërve të mi. Doja t'i largoja dhe të qëndroja vetëm përballë nënës. Nuk i kërkova ndjesë për atë që kisha bërë. I thashë se veprimi im e kishte ndihmuar të vdiste me dinjitet dhe se, falë saj, kisha kuptuar si të hiqja qafe pagjumësinë, atë të keqe që më brente prej aq shumë kohësh. Ajo kishte shmangur kalvarin në spitalet publike të Marokut, ku do të kishte pritur orë të tëra në korridor, që ndonjë mjek të kujdesej për të, para se të ngrinte sytë nga qielli dhe të më këshillonte ta ktheja në shtëpi që të vdiste qetësisht.

Kur u ktheva në shtëpi për të marrë valixhet dremita një çast, gjë që më ndodh rrallë. Pashë në ëndërr sikur

po hyja te “Jenane Sbile”, një park publik në Fes, kopshti i fëmijërisë sime. Asgjë nuk kishte ndryshuar e as lëvizur, gjithçka ishte atje. Liqeni, pemët, lëndina, pëllumbat, macet dhe qentë bredhacakë. Ajri ishte i thatë. Kisha etje. U afrova te një çezmë. Ajo ishte e thatë. Asnjë pikë ujë. U ktheva te liqeni. Uji kishte ngrirë. Ishte shndërruar në akull ku pasqyrohej një qiell i hirtë, pothuajse i zi. Megjithatë, ishim në mes të verës. Isha vetëm në atë vend familjar. Një vend i çuditshëm, i huaj. Pastaj u ula në një stol dhe prita. E dija se dikush do të vinte të më lante fytyrën me ujë të sjellë nga Meka. Nuk besoja në virtytet e tij, por e pranoja atë ritual. Një i vdekur po afrohej drejt meje. Një fantazmë si në disa filma. Ishte i mbështjellë me qefinin e tij të bardhë me njolla balte ngjyrëkafe. Ecte mekanikisht. E kuptova se duart e tij të zhytura në ujin e Zemzemit do t’i kalonte shumë herë mbi fytyrën time. Me vete thashë: “Çfarë do të bëja për të mposhtur pagjumësinë?”. I vdekuri kaloi para meje pa u ndalur. Njoha Markezin. E ndiqte pas Lalla Zinebja, gjysmëmotra ime, me fytyrën e zbuluar. Në fakt, dikush më kishte dërguar në atë park për të marrë pjesë në paradën e njerëzve, vdekjen e të cilëve e kisha nxituar unë. Isha i lidhur për stoli, nuk lëvizja dot, sikur një dorë metalike mëshonte mbi supet e mia me të gjithë peshën e saj. Edhe pse nuk kisha bërë asgjë të gabuar, iu kisha shkurtuar vetëm vuajtjet, Allahut nuk i pëlqente kjo lloj veprimtarie. Vetëm Ai vendos për fundin e secilit. Kjo është arsyeja përse të gjitha fetë

e dënojnë ashpër vetëvrasjen. Në islam, ai që guxon të sfidojë Allahun dhe të vrasë veten, është i dënuar ta përsërisë këtë veprim pafundësisht. Kjo është arsyeja përse duhet ta zgjedhim mirë vetëvrasjen. Përfytyroni dikë që i vë zjarrin vetes, dikë që hidhet nga kati i njëzetë, ose që e mbyt veten me një qese plastike! Më mirë është kutia me hape gjumi. Të paktën kështu, përsëritja nuk është shumë e dhimbshme. Oh, vdes në gjumë të thellë, përjetësisht! Gjithsesi, nuk bëhet fjalë të vras veten. Unë që vdisja të tjerët, nuk do t'ia bëja këtë vetes, nuk kishte kuptim.

Kisha një ndjenjë të turbullt, ku përzihej frika dhe vuajtja. Shikoja gjëra që zhdukeshin sa hidhja sytë mbi to. T'i shihja, do të thoshte t'i shkatërroja. Por jo të vdekurit. Ata vazhdonin shëtitjen para meje, të paaftë për të reaguar.

Parku ishte përmytur nga një dritë artificiale. Ajo luante rolin e filtrit, të perdes mes pagjumësisë dhe meje që përpiqesha t'i shpëtoja makthit.

Pastaj, drita u fik ngadalë dhe u gjenda në një hapësirë krejt ndryshe. Kreditet e mia të gjumit me sa dukej kishin shterur, ose nuk funksiononin. Të vdekurit kishin ardhur në atë kopsht për të më thënë këtë gjë. Tashmë isha i rrethuar nga rrënoja rrethore, ku çdo përpjekje për të shpëtuar ishte e dënuar të dështonte. Hodha sytë përreth, një realitet i stisur nga një fat qorr me një sy. Nuk njihja më asgjë dhe kisha bindjen se nuk kisha vrarë askënd. Megjithatë, ndërkaq, një listë e re kandidatësh, që nxitonin të vdisnin, më shpalosej në mendje.

## Kapitulli 10

Ndërkohë që mbyllja shtëpinë për t'u larguar mundësisht sa më shpejt nga Tanzhei, Toni më telefoni me zërin e tij të thellë. Donte të më takonte urgjentisht.

Gjysmë ore më pas mbërriti në shtëpi me një dosje gri, të cilën e shtrëngonte fort.

- Mbreti ka ngritur një komision “Barazi dhe Pajtim” për të vendosur drejtësinë për viktimat e padrejtësive të kryera gjatë sundimit të Hasanit II, për të riparuar dëmin që vendi u ka bërë mijëra marokenëve, kundërshtarë apo aktivistë të thjeshtë të të drejtave të njeriut gjatë viteve të terrorit. Por ky organ ka hequr dorë nga ndjekja penale e personave përgjegjës për zhdukjet dhe torturat. Kjo është absurde dhe e padrejtë, burrat dhe gratë, që kanë vuajtur torturat më të egra, do të kompensohen me pará, ndërsa për xhelatët e tyre nuk do të bëhet asgjë.

E vështrova, duke sjellë sërish në mendje miqtë e torturuar dhe ata që ishin zhdukur. I mërguar në Francë në atë periudhë, kisha mundur t'i shpëtoja

asaj policie paralele tejet të frikshme. Toni vazhdoi shpjegimin e tij:

- Xhaxhait tim i ka rënë në dorë një dosje e tmerrshme, ajo e një xhelati të madh, i cili ka qenë krahu i djathtë dhe dora e majtë e Basriut, e të famshmit ministër të Brendshëm. Hasani II i besonte verbërisht dhe e kishte në vend të kryeministrit. Ai qëndronte në hije, por ishte njeriu më i fuqishëm i regjimit. Me sa duket kishte në pronësi të gjithë qytetin Setat. Nuk ia di emrin e saktë, por kam vetëm një numër me katër shifra të ndjekur nga shkronja J e madhe. Mendoj se emrin e ka Jazid, po, po, Jazid.

E dëgjoja dhe e merrja me mend se çfarë do të më kërkonte. I thashë menjëherë se nuk bëhej fjalë.

- Por ai është i sëmurë, ka kancer me metastaza... Mendoj se një shtysë e vogël, një ndyrësirë e këtij kalibri, do të të jepte shumë kredite gjumi.

- Ku e ke llafin?

- Ti nuk e mban mend, por një natë kishe pirë shumë dhe më tregove se duke vrarë ndyrësira arrije të flije mirë. Pra, më mirë se ky pleh nuk ka! Xhelat! Tërë jetën ke luftuar për të drejtat e njeriut, - tha Toni. - Nuk bëhet fjalë që një bastard i tillë të vdesë i qetë në shtrat. Duhet të vuajë pak para se të vdesë; kjo është më e pakta që mund të bësh për qindra qytetarë marokenë që kanë kaluar në duart e tij në bodrumin e vilës Dar-el-Mokri. Ti e di, në rrugën "Zaers" në Rabat.

Bërtiste, i bindur se kishte të drejtë dhe se duhej patjetër të hidheshim në veprim.

- Por ai po vdes; është tepër vonë për të ndërhyrë.

- Jo, i kam marrë të gjitha masat, mjafton të më ndjekësh dhe nesër do të heqim qafe një lëtyrë më të keqe se Pedofili. I vetmi problem është se duhet të zhvendosemi, ai është shtruar në Spitalin Ushtarak të Rabatit, spitali më i mirë i mbretërisë, në katin e parë, dhoma 52, i ruajtur ditë e natë nga dy policë të veshur civilë. Por e ndiej se zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme do të ishin shumë të lehtësuar po të ngordhte shpejt. Ish-xhelati mund të vendosë të flasë dhe të shqetësojë shumë njerëz.

- Si mendon të mbërrish tek ai?

- Gjeta kartën e identitetit të djalit të tij të madh, i cili aktualisht kurohet për depresion të “Beni Makada”. Çuditërisht, ti i ngjan shumë, shiko fotografinë, duket sikur je ti. Do të prezantohemi, ti si djali i tij, do të nxjerrësh kartën e identitetit, ndërsa unë si shoferi yt. Ke për ta parë, nuk do të ketë asnjë problem, atë nuk e njeh askush në spital, nuk e dinë as se ku ndodhet tani.

Të them të drejtën, ideja për të vrarë një plehrë të dytë brenda një muaji më pëlqente disi. Por ishte mjaft e rrezikshme, sepse vendi ishte i ruajtur mirë. Gjithsesi, ia vlente të provoja një goditje të fundit para se të qetësohesha përfundimisht dhe të shijoja netët e mia, të cilat ishin bërë përherë e më të dendura dhe të mbushura me ëndrra dhe histori. Prapë nuk më ndahej vërejtja e Hitchcock-ut për vështirësinë e vrasjes së dikujt vetëm me duar, pa përdorur armë zjarri, gjë që

në rastin tim nuk bëhej fjalë. Unë nuk isha vrasës, isha “kuzhinier” i vdekjes.

Gjatë rrugës, makinën e ngiste Toni, ndërsa unë lexoja dosjen gri. Brenda ishte një fletore, ku ndyrësira shënonte emrat dhe moshën e të burgosurve që torturonte, pa bërë asnjë koment tjetër. Ndonjëherë shkruante anash llojin e torturës që përgatiste. Me sa dukej, ishte ekspert, ndoshta i stërvitur në Amerikën Latine. E çuditshme ishte fytyra e tij, tërësisht e ëmbël dhe njerëzore, pa ndonjë gjurmë ligësie apo mizorie. Mund të kishte qenë profesor universiteti ose biznesmen i qetë. Në të vërtetë, torturonte njerëz pa i bërë pyetje vetes, këtë punë kishte, paguhej mirë dhe vepronte me shumë kujdes dhe me efektshmëri. Mbi të gjitha, nuk i keqtrajtonte fizikisht, nuk i vdiste gjatë marrjes në pyetje.

Në darkë duhej të takonte gruan dhe fëmijët, të darkonte me ta, të shikonte televizor dhe t’i jepte secilit një puthje para se të flinte në paqe. Gruaja, me sa duket, nuk ishte në dijeni të detyrave që ai kishte në Ministrinë e Brendshme. Asaj nuk i mungonte asgjë, merrte dhurata nga shefi, të shoqin e adhuronte. Kishte vetëm një brengë: ai nuk kishte kohë ta shoqëronte në Mekë për pelegrinazh. I thoshte: “E lëmë kur të dal në pension. Tani kemi shumë punë, nuk marrim dot as lejen vjetore”. Por, kur mbërriti dita e daljes në pension, doli me kancer. Kishte më shumë se dy vjet që zvarritej nëpër spitale. A mendonte ndonjëherë për ata që i kishte bërë të vuanin aq shumë? Aspak. Ai



i përkiste një ingranazhi të përkryer, ku askush nuk përpiket të kuptojë. Një ditë, një oficer i kishte thënë: “Po bëre pyetje, je i vdekur”. Këtë e kishte shkruar në një faqe të dosjes.

Toni e ngiste makinën me kujdes dhe unë lexoja në fytyrën e tij një lloj padurimi për të mbërritur në Rabat, për ta kryer, më në fund, atë krim. Cila ishte vallë origjina e kësaj etjeje për hakmarrje? E pyeta, por ai tha se e bënte thjesht për miqësinë e pastër që kishte ndaj meje. Sigurisht, po më bënte nder, por isha i bindur se njëkohësisht lante një hesap të vjetër personal me Jazidin.

Sa mbërritëm në Rabat, vendosa të merrja dy dhoma te “Balima”, një hotel që dikur ishte i famshëm. Sot ishte një grua e vjetër pa dhëmbë, e lodhur, por ruante ende disa gjurmë të shkëlqimit të rinisë së saj. E lamë veturën në parking.

I shpjegoja Tonit se nuk duhet të nguteshim dhe se duhej t’i përgatisnim gjërat me përpikëri. Ai lëshoi një britmë: “Me përpikëri? Por nga doli kjo tani? Ndonjë nga dashnoret e tua? Oh, jo! Nuk duhen përzier gratë në punët tona, kjo është mënyra më e mirë për t’i prishur të tëra”.

U shtira sikur shpjegoja fjalën, duke qeshur me shakanë e tij pak të trashë, të cilën duhet ta kishte huazuar nga një film i famshëm, ku Fernandeli, në rolin e gangsterit, jep një përgjigje pothuajse të ngjashme.

Përpikëria ishte të gjenim *Tracrium*, i njohur ndryshe me emrin *curare*, një anestetik që do të

përzihej me sufentanil. Përzierja e të dyja barnave, e injektuar ngadalë në vena, shkaktonte vdekjen e menjëhershme dhe nuk lë gjurmë po të bëhet autopsia. Por nuk u bëhet autopsi kujtimeve të këqija të viteve të terrorit, ato zhduken sa më shpejt që të jetë e mundur edhe në këtë spital të ruajtur mirë. Mandej, *Human Rights Watch* e kishte përmendur këtë në një raport dhe po përgatitej të vinte së shpejti për të hetuar xhelatët e viteve tetëdhjetë.

Toni nuk ishte vetëm portier në klinikë, pak nga pak kishte marrë kompetencat e ndihmësmjekut dhe të infermierit; kishte njohuri mjekësore të mira. Propozoi të merrej vetë me barnat, sepse kishte njohjet e duhura, por nuk pranoi të më thoshte emrat e tyre. E lashë të vepronte dhe, në pritje, vendosa të merrja një sy gjumë në dhomën e hotelit.

Ideja për ta çliruar tokën nga një xhelat me pamje të një njeriu të mirë, myslimani të mirë, prindi të mirë dhe bashkëshorti të mirë, më ngazëllente dhe rashë pa vështirësi në një përgjumje të këndshme. Kisha përshtypjen se flija me një sy hapur, duke shijuar kënaqësinë e largimit pa u larguar vërtet. Një lloj marramendjeje e vogël, e cila më krijonte ndjesinë e të qenët i lehtë, sikur pluskoja në ajër dhe i buzëqeshja jetës.

Në darkë, Toni u kthye triumfues, me grushtin e ngritur lart sikur të kishte fituar kampionatin botëror të xhepistit. Kishim koktejin vdekjeprurës, tashmë mbetej vetëm përgatitja e operacionit.